



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

---

Numri i lëndës: 2022:070737

Datë: 06.03.2024

Numri i dokumentit: 05420270

P.nr.176/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA NË KLINË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjykuese Sabrije Rraci, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Liridona Palushi, në çështjen penale kundër të pandehurve H. T nga fsh. N.K.K Republika e Shqipërisë, tani me vendqëndrim në P, te Rr.,M. F'' C/15 kati i 4 nr. 23 te banesa e F.Q i akuzuar për shkak të veprës penale Organizim i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par 2 lidhur me nenin 81 të KPRK-së dhe J. B, nga Tirana Republika e Shqipërisë, përfaqësues i personit juridik "LOTTO SPORT SHPK", tani me vendqëndrim në P, te Rr., M.F'' C15/15 kati i 4 nr. 23 te banesa e F.Q i akuzuar për shkak të veprës penale Organizim i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par 2 lidhur me nenet 40 dhe 81, të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, PP//II nr. 2707/2021 e dt. 10.08.2022, pas shqyrtimit fillestar publik të mbajtur me dt. 07.02.2024, në praninë e Prokurorit të shtetit Ramiz Buzhala, nga Prokuroria Themelore në Pejë, të pandehurit e lartcekur dhe mbrojtësve të tyre me datën: 06.03.2024 e përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj:

Të pandehurit: H (T) T, i lindur me 08.02.1978, në N. K, Republika e Shqipërisë, tani me vendqëndrim në P, biri i T dhe nënës H e vajzërisë B, me profesion ekonomist, ka të kryer akademinë ushtarake, i martuar, baba i dy fëmijëve, i identifikuar ne baze te

letërnjoftimit me numër personal ....., i nacionalitetit Shqiptar, Shtetas i Republikës së Shqipërisë, mbrohet ne liri.

Të pandehurit: J (R) B, i lindur me ....., në T. R e Sh, i biri i R dhe nënës L e vajzërisë S, ka të kryer fakultetin ekonomik, i divorcuar, me profesion përfaqësues i shitjes, i identifikuar ne bazë të letërnjoftimit me nr....., i nacionalitetit Shqiptar, Shtetas i Republikës së Shqipërisë, mbrohet ne liri.

## JANË FAJTOR

1.I pandehuri H. T, në cilësinë e personit përgjegjës të personit juridik "L. S, SHPK", si Drejtor Ekzekutiv/ Agjent i regjistruar, për shkak se:

Në kohë të pavërtetuar e gjer me datën ....., në fshatin G. në K, me dashje e në vazhdimësi e më qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo personin tjetër, ka organizuar, marr pjesë apo ndihmuar në organizimin e bixhozit, lojërave të llojit të kazinove/bastoreve apo lojërave të fatit pa pasur licencë për njësinë/filialën e personit juridik "L. S. SHPK", siç përcaktohet me ligj neni 25 dhe 70 të Ligjit nr.04/L-80, për lojërat e fatit, në atë mënyrë që :gjatë vizitës inspektuese të ATK-së nga Prishtina, në lokalin/filialën e lartcekur me datën 25.01.2018 kanë hasur se i pandehuri ka organizuar dhe ka angazhuar punëtorë dhe ka ushtruar veprimtari të bastores si lojë e fatit pa u pajisur me licencën për atë njësi/filiale nga organi kompetent A., me ç 'rast i shkakton dëm të dëmtuarit A...

-Me çka ka kryer veprën penale, Organizim i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par 2 lidhur me nenin 81 të KPRK-së (nr.04/L-082).

2.I pandehuri J.B, si përfaqësues i personit juridik "L. S SH" për shkak se:

Në kohë të pavërtetuar e gjer me datën ....., në fshatin G në K, përmes veprimeve si më lartë të personit përgjegjës si i autorizuar i personit juridik, kanë përfituar kundërligjshëm dobi pasurore për veten dhe për personin tjetër, duke lejuar të njëjtin

të organizojë, merr pjesë apo ndihmojë në organizimin e bixhozit, lojërave të llojit të kazinove/bastoreve apo lojërave të fatit pa pasur licencë për njësinë/filialën e personit juridik, siç përcaktohet me ligj neni 25 dhe 70 të Ligjit nr.04/L-80, për lojërat e fatit, në atë mënyrë që :gjatë vizitës inspektuese të A., nga Prishtina, me datën ..... në filialën/lokalin/njësinë e lartcekura në pikën I kanë hasur se personi juridik përmes personit përgjegjës të personit juridik kanë organizuar dhe kanë angazhuar punëtorë dhe kanë ushtruar veprimtari të bastores si lojë e fatit pa u pajisur me licencën për atë njësi/filiale nga organi kompetent ..., me ç'rast i shkakton dëm të dëmtuarit ATK,

-Me çka ka kryer veprën penale, Organizim i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par 2 lidhur me nenin 40 dhe 81 të KPRK-së (nr.04/L-082).

Prandaj gjykata në bazë të neneve 2, 4, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 41, 42, 43,44, 45, 46, 47, dhe nenit 300 par 2, lidhur me nenin 40 dhe 81 të KPRK-së (nr.04/L-082), si dhe nenit 364 të KPPRK-së, të pandehurit i:

## G J Y K O N

I Të pandehurit H. T, i shqiptohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj i cili dënim me pëlqimin e të pandehurit e konform nenit 44 të KPRK-së i zëvendësohet në dënim me gjobë në shumë prej 1000 (një mijë) euro të cilin dënim i pandehuri obligohet ta paguaj në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II. Nëse i pandehuri nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj gjobën e shqiptuar sipas afatit të dhënë, e njëjta gjobë do të zëvendësohet në dënim me burg, konform nenit 46 par.3 të KPRK-së, ku një ditë burgim do ti llogaritet në 20 euro të gjobës.

I. Të pandehurit J.B, i shqiptohet dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj i cili dënim me pëlqimin e të pandehurit e konform nenit 44 të KPRK-së i zëvendësohet në dënim me gjobë në shumë prej 1000 (një mijë) euro të cilin dënim i pandehuri obligohet ta paguaj në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II. Nëse i pandehuri nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj gjobën e shqiptuar sipas afatit të dhënë, e njëjta gjobë do të zëvendësohet në dënim me burg, konform nenit 46 par.3 të KPRK-së, ku një ditë burgim do ti llogaritet në 20 euro të gjobës.

III. Obligohen të pandehurit H. T dhe J. B, që në emër të paushallit gjyqësor në mënyrë solidarë të paguajnë secili nga dhjetë (10) euro, ndërsa në emër të tarifës për kompensim të viktimave të krimit secili veç e veç të paguajnë nga 20 (njëzetë) euro, të gjitha këto në afat prej 30 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

IV. E dëmtuara A... për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

## **A r s y e t i m**

### 1.Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Pejë Departamenti i Përgjithshëm, me datë 10.08.2022, ka ngrit aktakuzë me PP//II.nr. 2707/2022, ndaj të akuzuarve H. T nga Shqipëria tani me vendqëndrim në P, në cilësinë e personit përgjegjës të personit juridik "L. S.SHPK", si Drejtor Ekzekutiv/ Agjent i regjistruar, për shkak të veprës penale Organizim i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par 2 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, dhe J. B, nga Sh, pronar-përfaqësues i personit juridik "L.S.SHPK", për shkak të veprës penale Organizim i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par 2 lidhur me nenin 40 dhe 81 të KPRK-së.

Gjykata me datën 07.02.2024, ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar lidhur me këtë çështje juridiko-penale, në të cilën prezantuan prokurori i Prokurorisë Themelore në Pejë, Ramiz Buzhala, i akuzuari H. T, dhe mbrojtësi i tij avokati Florent Latifaj dhe i akuzuari J.B, dhe mbrojtësi i tij avokati Faton Qirezi.

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, të akuzuarit lidhur me fajësinë për veprat penale për të cilat akuzohen, secili veç e veç kanë deklaruar se: e ndjejnë veten fajtor për veprat penale me të cilat janë ngarkuar, janë penduar thellë për veprat që i kanë kryer dhe tani ndihen keq i premtojnë gjykatës që nuk do të përsërisin vepra të tilla apo të ngjashme.

Mbrojtësi i të pandehurit H.T, av.Florent Latifaj, lidhur me pranimin e fajësisë së të mbrojturi të tij ka deklaruar se i pandehuri H, e ka bërë pranimin e fajësisë pas konsultimit paraprak me të, i vetëdijshtëm për pasojat e pranimin të fajësisë duke shtuar se gjykatës i propozon që pranimin e fajësisë nga i pandehuri T ta aprovoj dhe të merr për bazë se vepra është kryer në vitin 2018 dhe nga ajo kohë nuk ka kryer vepër penale, moshën e tij, pranimin e fajësisë i njëjti nuk ka ra ndesh me ligjin dhe kërkoj që të njëjtit ti shqiptohet një gjobë jo më shumë se 1000 euro për shkak se do ta vështirësonte gjendjen ekonomike të pandehurit.

Mbrojtësi i të pandehurit J. B, av.Faton Qirezi, ka deklaruar se i pandehuri J.B, e ka bërë pranimin e fajësisë pas konsultimit paraprakë me të, i vetëdijshtëm për pasojat e pranimin të fajësisë andaj i propozojmë gjykatës që ta aprovojë pranimin e fajësisë nga i pandehuri J. B, duke shtuar që të merren për bazë se vepra është kryer në vitin 2018 dhe nga ajo kohë nuk ka kryer vepër penale, moshën e tij, pranimin e fajësisë i njëjti nuk ka ra ndesh me ligjin dhe kërkoj që të njëjtit ti shqiptohet një gjobë jo më shumë se 1000 euro për shkak se do ta vështirësonte gjendjen ekonomike të pandehurit.

Prokurori i shtetit, lidhur me pranimin e fajësisë nga të akuzuarit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve, pasi ky pranim i fajësisë është bërë pa presion, me vullnet nga të pandehurit dhe konform dispozitave të nenit 242 par 1 të KPPRK-së, andaj i propozoi Gjykatës që të njëjtit ta shpalli fajtor dhe ti dënoi sipas ligjit ndërsa si rrethanë lehtësuese ta merr pranimin e fajësisë.

## 2.Vlerësimi i pranimin të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjykata, pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar fajësinë nga i akuzuari H. T, për veprën penale për të cilën është ngarkuar, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore nga neni 300 par. 2 lidhur me nenin 81 të KPPK-së, dhe nga e i akuzuari J. B, për vepër penale për të cilën është akuzuar ngase janë plotësuar të gjitha kushtet ligjor nga neni 300 par 2 lidhur me nenin 40 dhe 81 të KPRK-së. Në këtë aspekt gjykata, ka konstatuar se të akuzuarit e

kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë dhe pas njoftimit nga ana e gjykatës lidhur me benifitet dhe pasojat e pranimi të fajësisë, ka vlerësuar se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga të akuzuarit, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

### 3.Gjendja faktike e vërtetuar:

Andaj duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjykata, e ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

-Se i akuzuari i H. T, ka kryer veprën penale , Organizim i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par 2 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e parë të këtij aktgjykim kurse i akuzuari J.B, ka kryer veprën penale , Organizim i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par 2 lidhur me nenin 40 dhe 81 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e dytë të këtij aktgjykimi.

### 4.Vendimi për shpalljen fajtor

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, gjykata, ka vendosur që të akuzuarit e lartcekur, t'i shpall fajtor për kryerjen e veprave penale sipas aktakuzës së cekur më lart, meqenëse është vërtetuar se të njëjtit i kanë kryer veprat penale siç edhe vet e kanë pranuar sikurse në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar në dispozitivat e aktgjykimit dhe për të njëjtat vepra janë përgjegjës. Kjo për faktin se siç e kanë pranuar edhe vet, të akuzuarit në ditën kritike për të cilën akuzohen kanë ndërmarrë të gjitha veprimet e cekura në aktakuzë.

5.Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit: Me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të akuzuarve H. T dhe J. B, Gjykata, i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, sipas neneve 69 dhe 70 të KPK-së.

Në këtë aspekt, si rrethanë lehtësuese, mbi bazën e së cilës gjykata i ka shqiptuar dënimet për veprat penale sikurse më lart, është fakti se të akuzuarit e kanë pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar, e që kjo është rrethanë e cila duke i ndërlidh me

rrethanat tjera, si fakt se të njëjtit janë penduar për veprat e kryera, se nuk kanë qenë të dënuar me parë ashtu që gjykatës i kanë premtuar se nuk do ta përsërisin më veprat penale. Ndërsa, gjykata si rrethanë rënduese gjeti dashjen e kryerjes së veprës penale si në dispozitivat e këtij aktgjykimi.

6. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprave penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarve dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar.

7. Sipas bindjes së gjykatës, për të akuzuarit H. T, dhe J. B, për secilin veç e veç dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj i cili dënim me pëlqimin e të pandehurve e konform nenit 47 të KPRK-së iu është zëvendësuar në dënim me gjobë në shumë prej 1000 (një mijë) euro të cilin dënim të pandehurit obligohen ta paguaj në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, janë dënime të drejta, në harmoni me peshën e veprave penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarve.

Gjykata ka konstatuar se me këto dënime mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmën dhe të bëjë rehabilitimin e tij, por edhe (për mundësinë që të kthehet në një element kontribues për vete, familjen dhe për rrethin ku jeton) të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi shpenzimet

Vendimi për shpenzimet e procedurës dhe paushallit gjyqësor është i bazuar në nenin 452 par. 1 dhe nenit 449 par. 2 të KPPRK-së, ndërsa vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë, konform nenit 39 par. 3 nën par. 3.1 të Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga arsyet e cekura më lartë e në bazë të neneve 242 dhe nenit 364 dhe 369 të KPPRK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEGA KLINË

DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM

P.nr.176/2022 me datë 06.03.2024

Zyrtare Ligjore

Liridona Palushi

Gjyqtarja

Sabrije Rraci

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e pranimi të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj gjykate themelore.